



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0218**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi-Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Envinion”, me seli në Prishtinë, e parashtruar, kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dizajnimi i identitetit të ri të kryeqytetit” me numër të prokurimit 616-22-12339-2-2-2, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 13.07.2023, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “Envinion” sh.p.k., me nr. 2023/0218, e datës 18/04/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dizajnimi i identitetit të ri të kryeqytetit”, me numër të prokurimit 616-22-12339-2-2-2, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 04.11.2022, ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Hapja e ofertave është bërë me datë 25.11.2023. Me datë 30.03.2023, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dizajnimi i identitetit të ri të kryeqytetit” me numër të prokurimit 616-22-12339-2-2-2.

Me datë 04.04.2023, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 06.04.2023, AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit

Ekonomik “Envinion” sh.p.k., për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim “Envinion” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me datën 18.04.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 218/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kufizuar me dy faza, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 €.

Palët janë njoftuar me raportin e ekspertizës, me datë: 02 maj 2023. Me datë 03.05.2023, AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE ankues “Envinion” sh.p.k. me datë 08.05.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 05 maj 2023 ka rekomanduar që:

-Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Envinion” sh.p.k., me seli në Prishtinë.

-Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 30.03.2023 (*vendim për dhënie të kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Envinion” sh.p.k., me seli në Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me kërkesën për rishqyrtim “Ky rivlerësim, nga Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, kemi kuptuar se ishte bërë për shkak të Kërkesës për Rishqyrtim të Operatorit Republika, mirëpo që e njëjta nuk ka qenë publike dhe as që ka qenë publik vendimi për aprovimin e kësaj kërkesë. (Provë 1 – Pasqyra e platformës së e-prokurimit tek detajet e aktivitetit të prokurimit ku do të duhej të publikohej Vendimi për Pezullimin e Procedurës dhe Vendimi për Aprovimin e Kërkesës për

Rishqyrtim).”

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja me datën 15.03.2023 përmes platformës se e-prokurimit ka pranuar kërkesë për rishqyrtim nga OE Republika.

Me datën 16.03.2023 AK-ja e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit derisa me datën 17.03.2023 ka publikuar edhe njoftim për shtyrje të afatit për shqyrtim të kërkesës së OE deri me datën 21.03.2023. AK-ja ka publikuar vendimin në kërkesën për rishqyrtim të OE me datën 20.03.2023.

Te gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura në sistemin e e-prokurimit prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me “Në këtë arsyetim vërehet qartë se nuk është konstatuar drejt gjendja faktike, pasi që nga njoftimi i AK, vetëm se ishin kualifikuar vetëm gjashtë operator, që do të thotë se nuk kishte vend për rivlerësim të ofertave.”

Eksperti shqyrtues sqaron se sikur është vërtetuar në pretendimin e parë AK-ja ka pranuar kërkesë për rishqyrtim të cilën e ka pranuar si të bazuar me vendimin e datës 20.03.2023 dhe ka rivlerësuar aplikacionet ku ka vlerësuar se OE që ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim është i përgjegjshëm.

Duke u bazuar në vlerësimin e fazës së parë ku janë kualifikuar gjashtë OE dhe pasi kërkesa për rishqyrtim është aprovuar si e bazuar në procesin e rivlerësimit numri i OE të kualifikuar shtohet edhe për një që do të thotë janë shtatë aplikacione të kualifikuara. Bazuar në RRPP 001/2022 Neni 47 paragrafi 47.17 Nëse numri i kandidatëve të përshtatshëm që plotësojnë kushtet e përzgjedhjes është më i madh se maksimumi prej gjashtë (6), pikat e forta dhe dobësitë relative të aplikacioneve të këtyre kandidatëve duhet të rishqyrtohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderimit. AK-ja në këtë rast ka vepruar në përputhje me RRPP 001/2022 dhe ka rishqyrtuar aplikacionet prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr. 3 Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me “Ndër operatorët tek të cilët është kërkuar sqarime ishte edhe operatori Republika. I njëjti nuk ka askund të dhëna në platformën e e-prokurimit se i ishte përgjigjur autoritetit kontraktues në lidhje me informatat e kërkuara.

Këtë pretendim e bazojmë në dy burime, platformën e eProkurimit dhe qasjen në dokumente zyrtare, ku nga këto dy burime nuk kemi gjetur asnjë provë se operatori është përgjigjur në kërkesën për sqarime të ofertës” si dhe pretendimit se është bërë shkelje e nenit 38 të RRPP eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa për sqarim është ngarkuar në sistemin e prokurimit me datën 11.01.2023.

Duke u bazuar ne kërkesat nga neni 38 i RRPP eksperti shqyrtues ka kërkuar sqarim nga AK-ja për mënyrën se si janë pranuar sqarimet e kërkuara. Nga dëshmitë e dërguara ne email te datës 02.05.2023 nga AK-ja shihet se shumica e OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit kanë has në probleme me bashkëngjitjen e dokumenteve në platformën e e-prokurimit.

Sa i përket pretendimit te OE ankues për shkelje te nenit 38.6 dhe 38.7 eksperti shqyrtues sqaron se këto nene i referohen ne rastet kur OE nuk i përgjigjet kërkesës për sqarim e qe nuk është e aplikueshme këtu.

Përmes emailit AK-ja ju ka lejuar të gjithë OE që në pamundësi të bashkëngjitjes se dokumenteve të njëjtat mund të dërgohen edhe përmes emailit (provë: emaili i datës 02.05.2023). Eksperti shqyrtues sqaron se përkundër faktit te kërkesës se RRPP nenit 38, duhet ti referohemi edhe nenit

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Neni 55 Mënyrat e Komunikimit

1.Përveç gjatë vend-shikimeve ose mbledhjeve para-tenderimit, të gjitha komunikimet dhe këmbimet e informacioneve ndërmjet operatorëve ekonomik dhe një autoriteti kontraktues dobëhen: (i) me shkrim – në letër, me faks dhe/ose në mënyrë elektronike dhe (ii) në përputhshmëri me të gjitha dispozitat e tjera të aplikueshme të këtij ligji.

Neni 4 Përkufizimet

1.21 Mjetet elektronike – përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë kompresimin shifror) dhe ruajtjen e të dhënave të transmetuara, të bartura ose të pranuar me telegraf, me radio, me mjete pamore, ose me mjete tjera elektromagnetike.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pas administrimit te provave materiale është vërtetuar se AK-ja ka vepruar ne përputhje me Nenin 7 te LPP-se, nenin 72 dhe nenin 55 lidhur me nenin 4 paragrafin 1.21 prandaj konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me “Sipas Rregullave të Prokurimit Publik, ri-shqyrtimi ndodh vetëm në rastet kur numri i aplikimeve e kalon numrin prej gjashtë ofertave të kualifikuara.” Eksperti shqyrtues vlerëson se këtij pretendimi i është dhënë përgjigje ne përgjigjen e pretendimit nr.2.

### Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me vërejtjet në kontratat e dorëzuara nga OE Republika si dhe vërejtja se nuk janë dorëzuar referencat për përfundim të suksesshëm të punëve eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata të ngjashme të identiteteve apo të institucioneve, kompanive, në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrate).

Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja nuk kishte kërkuar kopje të kontratave por një listë të kontratave ku si dëshmi janë kërkuar vetëm informatat e kontratës prandaj pretendimi në përmbajtje të kontratës nuk qëndron.

Sipas raportit të rivlerësimit të aplikacioneve AK-ja në bazë të sqarimeve shtesë të marra nga OE-të ka bërë vlerësimin. Sipas raportit të vlerësimit AK-ja kishte përfshirë vetëm dy kontrata të OE Republika që e përmbushin kërkesën në përputhje me dosjën e tenderit – kriteret teknike profesionale. Për këto kontrata OE kishte prezantuar referenca sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Kontratat e pranuar në përputhje me kërkesat e dosjës së tenderit e tejkalojnë dyfish vlerën e kontratave të OE ankues.

Prandaj bazuar në ofertën e OE të kualifikuar dhe vlerësimit të AK-se rezulton se Ak-ja ka vlerësuar drejtë kontratat dhe referencat kështu që pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar.

### Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me shkeljet e nenit 47 të RRPP 001/2022 të kriterit të vlerësimit citim “poashtu kemi vërejtur se kriteri i vlerësimit të ofertave ishte:

“Vlera e kontratave të përfunduara me sukses” që do të thotë se vlerësimi nuk është bërë në përputhje me Nenin 47 të Rregullave të Prokurimit Publik në të cilin thuhet: “Gjatë rishqyrtimit, Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë për rishqyrtim vetëm faktorët e publikuar në Njoftimin e Kontratës.

Autoriteti Kontraktues mund të merr parasysh vetëm kriteret e kapacitetit financiar ose teknik si kriteret shtesë.” Në rastin përkatës autoriteti kontraktues duhet që vlerësimin ta bëjë mbi bazën e këtyre kriterëve, por jo duke u bazuar në kontratat e përfunduara, pasi që referencat mund të jenë vetëm element kualifikues (i llojit kalon, nuk kalon) por jo edhe kriter me të cilin poentohet një operator më shumë sesa një tjetër.”

Eksperti shqyrtues gjatë administrimit të provave ka gjetur se AK-ja në përputhje me legjislacionin detyësor nën 47 ka përdorur procedurën e kufizuar në dy faza.

a. Në fazën e parë, fazën e Parakualifikimit, të gjithë Operatorët ekonomik ftohen t'i dorëzojnë kërkesat që të marrin pjesë në procedurë. Autoriteti Kontraktues zgjedh Operatorët Ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale të kritereve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kontratës.

AK-ja në përputhje me nën 47.15 dhe 47.16 të RRPP 01/2022 ka sqaruar aplikacionet në fazën e parë.

Duke pas parasysh përgjigjen në pretendimin nr 2 AK-ja ka bërë rivlerësimin në përputhje me nën 47.5 të RRPP dhe nën 49.20 të UOPP:

47.5 Të gjithë kandidatët pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar duke demonstruar ose konfirmuar se kandidatët janë të përshtatshëm dhe i plotësojnë kërkesat minimale të kualifikimit, do të konsiderohen të para-kualifikuar dhe të përzgjedhur për të marrë një ftesë përtender, përveç nëse numri i kandidatëve të tillë kalon numrin gjashtë (6).

Nëse numri i kandidatëve të përshtatshëm që plotësojnë kushtet e përzgjedhjes është më i madh se maksimumi prej gjashtë (6), pikat e forta dhe dobësitë relative të aplikacioneve të këtyre kandidatëve duhet të rishqyrtohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderimit.

Gjatë rishqyrtimit, Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë për rishqyrtim vetëm faktorët e publikuar në Njoftimin e Kontratës. Autoriteti Kontraktues mund të merr parasysh vetëm kriteret e kapacitetit financiar ose teknik si kritere shtesë. Në bazë të RRUOPP nën 49.1 Kriteret që mund të merren në konsideratë për të përcaktuar renditjen relative të Operatorëve ekonomik të kualifikuar nuk ka nevojë që të jenë të njëjta me ato të përdorura për të përcaktuar nëse Operatorët ekonomikë janë të kualifikuar.

Kritere shtesë (të përzgjedhura nga lista e kritereve të përzgjedhjes të LPP-se) gjithashtu të mund të përdoren. Në çdo rast, këto kritere shtesë duhet të synojnë identifikimin e atyre Operatorët ekonomik që janë të kualifikuar me se miri për të kryer kontratën. Prandaj, ato duhet të ndërliken me kontratën që do të jepet.

Prandaj në bazë të shembullit të dhënë në RRUOPP e përcakton qartë se në cilat raste mundet të përdoren edhe vlerat e kontratave të përfunduara si kriter shtesë për vlerësimin e aplikacioneve.

IV.1.2) Kufizime në numrin e Operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo e negociuar) “Në bazë të aplikacioneve të pranuar, së paku 3 dhe më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate.

Nëse me shumë se 6 kandidatë të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të tyre kandidatëve do të ri ekzaminohen për

të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

Vlera e përgjithshme e tri (3) kontratave, të përfunduara me sukses që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përcaktuar në Njoftimin për Kontrate Seksioni III.2.4 pika a) ("Operatorët ekonomikë kanë përfunduar me sukses të paktën dy kontrata për furnizim me kompjuterë të një vlere minimale prej 100,000 Euro në secilin vit gjatë dy viteve të fundit");

Prandaj pas shqyrtimit të pretendimit dhe duke marrë për bazë dokumentet e ngritura në sistemin e e-prokurimit Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar. Të mbetet në fuqi i Njoftimi për vendim i datës 30.03.2023, dhe ti lejohet AK-së vazhdimi i procedurës në fazën e dytë.

### *- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

### *- Përfundim -*

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshme ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisat gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " ENVINION " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: